

NË EMËR TË POPULLIT

Më
Data

28.09.2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe me sekretaren juridike Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] nga Prishtina, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 327 par.1 nënpar 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP nr.2359-2/13 të datës 03.07.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor fillestar me dt. 22.02.2017, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit shtetit Avdullah Abedini, përfaqësuesit të dëmtuarës [REDAKTUAR] në Ferizaj [REDAKTUAR] si dhe të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. [REDAKTUAR] të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari [REDAKTUAR], nga Prishtina, rr.” [REDAKTUAR] (L [REDAKTUAR]), i lindur më [REDAKTUAR], në të njëjtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma S [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], student, I pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal [REDAKTUAR].

ËSHTË FAJTOR

1. Sepse me date 17.10.2013, në fshatin Muzeqinë komuna Shtime, në intervalin kohor prej 21.30 e deri më 23.00, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së tjetrit me përdorimin e forcës dhe me mjete të përshtatshme ka marr një amplifikator (përforcues) të tipit Teleste –CXE202 pronë e kompanisë “ [REDAKTUAR], i cili pasi që e kishte marrë të njëjtin e kishte dërguar në shtëpinë e tij ku i njëjti i është konfiskuar nga ana e Policisë,
2. Me date 17.10.2013, në fshatin Reçak komuna Shtime, në intervalin kohor prej 21.30 e deri më 23.00, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së tjetrit me përdorimin e forcës dhe me mjete të përshtatshme ka marr një amplifikator (përforcues) të tipit Teleste –CXE202 të rrjetit kablovik të kompanisë [REDAKTUAR], i cili pasi që e kishte marrë të njëjtin e kishte dërguar në shtëpinë e tij ku i njëjti i është konfiskuar nga ana e Policisë,
3. Me datë 17.10.2013, në Lagjen e Pajtimimit komuna Shtime, në intervalin kohor prej 21.30 e deri më 23.00, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së tjetrit me përdorimin e forcës dhe me mjete të përshtatshme ka marr një amplifikator (përforcues) të tipit Teleste –CXE202 të rrjetit kablovik të kompanisë [REDAKTUAR], i cili pasi që e kishte marrë të njëjtin e kishte dërguar në shtëpinë e tij ku i njëjti i është konfiskuar nga ana e Policisë,

me këtë ka kryer në vazhdim veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar 1 lidhur me neni 81 të KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 4,6,7,23,41,43,46, 49, 50, 51 dhe 73 të KPK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së,e

GJYKON

DENIM ME GJOBË në lartësi prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 të KPK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € i pandehuri do të vuaj një ditë burgu.

Si dhe DËNIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 8 /tetë/ muaj, dhe në të njejtën kohë urdhëron që dënimi me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 2 /dy/ vite pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

E dëmtuara "██████████", me seli në Ferizaj, rr. "██████████", për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Përfaqësuesi i kompanisë "██████████" Ferizaj, ka hek dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

Obligohet i akuzuari të paushallit gjyqësor shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II nr.2359-2/13 të dt.03.07.2014 e ka ngarkuar të pandehurin "██████████" nga Prishtina, për shkak të veprës penale në vazhdim vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor fillestar me datë 22.02.2017, ku Prokurori i Shtetit Avdullah Abedini, fillimisht para leximit të aktakuzës ka bërë precizimin e aktakuzë duke deklaruar se pasi që në këtë aktakuzë kemi të bëjmë me vepër penale në vazhdim ashtu që ka bërë edhe ndarjen e diapozitivave për secilën vepër penale sipas vendit të kryerjes së veprave penale, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari [REDACTED], ne shqyrtimin gjyqësor, me rastin e njoftimit për të drejtën e sajë që të pranoj fajësinë apo të deklarohet e pa fajshëm në kuptim të nenin 246 par.4 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, duke theksuar se për këtë vepër është penduar thellë, se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin dhe duke premtuar se ë të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

Me që i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtim gjyqësor gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lëndes siç janë: procesverbali i marrjes së deklaratës nga i pandehuri me autorizimin e prokurorit të shtetit i datës 18.10.2013, procesverbali i marrjes së deklaratës nga i i dëmtuari [REDACTED] e dhënë me autorizimin e prokurorit të shtetit i datës 18.10.2013, procesverbali i marrjes së deklaratës nga i dëmtuari [REDACTED] me autorizimin e prokurorit të shtetit i datës 18.10.2013, procesverbali i marrjes së deklaratës nga i dëmtuari [REDACTED] me autorizimin e prokurorit të shtetit i datës 18.10.2013, vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve i datës 24.10.2013, vërtetimi mbi lirimin e sendeve i datës 19.10.2013 si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabim faktik, andaj shqyrtimi gjyqësor konform 356 të KPPK-së ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari individual konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në vazhdim veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 nënpar 1 lidhur me neni 81 të KPRK-së, ku i pandehuri me dashje si në datën, kohën dhe vendin e përshkruar në dispozitivet I, II dhe III të këtij aktgjykimi me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së tjetrit me përdorimin e forcës dhe me mjete të përshtatshme, fillimisht në fshatin Muzeqinë komuna Shtime ka marr një amplifikator (përforcues) të tipit Teleste –CXE202 pronë e kompanisë [REDACTED], pastaj njëjtë ka vepruar edhe në fshatin Reçak komuna Shtime me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së tjetrit me përdorimin e forcës ka marr një amplifikator (përforcues) të tipit Teleste –CXE202 pronë e kompanisë [REDACTED], gjithashtu edhe në Lagjen e Pajtimit komuna Shtime I pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të

pasurisë së tjetrit me përdorimin e forcës dhe me mjete të përshtatshme ka marr një amplifikator (përforcues) të tipit Teleste –CXE202 pronë e kompanisë [REDAKTUAR].

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e procedurës penale, sjelljen e tij korrekte, pendimin e shprehur, se është hera e parë që ka kryer ndonjë veprë penale, rrethanat e tij familjare se i njëjti është i fejuar, tani është student, e në mungesë të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të te pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale, mbi bazën e këtyre rrethanave të tilla gjykata konform nenit 75 dhe 76 të KPRK-se për të pandehurin [REDAKTUAR] bëri zbutjen e dënimit dhe i vërtetoi dënimin me gjobë në lartësi prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 8 /tetë/ muaj, dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimi me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 2 /dy/ vite pasi ky aktgjykim të merre formën e prerë nuk do të kryej veprë tjetër penale, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

E dëmtuara [REDAKTUAR], me seli në Ferizaj, rr. [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në contest civil.

Përfaqësuesi i kompanisë [REDAKTUAR] Ferizaj, [REDAKTUAR] në séance gjyqësore ka deklaruar se hek dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 /njëzetë/ € në afat prej 15 ditëve nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni
penal, P.nr.765/14, dt.22.02.2017**

Sekretarja Juridike ,

Drifta Ujupi

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa

Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej

15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të

kësaj gjykate.

Gjyqtari,

Mustaf Tahiri

E. X. P.
22.2.17

[REDAKTUAR]